Q.G; E-Mail i datës 26.06.2024 nga Q.G për A.K; E-Mail i datës 26.06.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 25.06.2024 nga Q.G për A.K; E-Mail i datës 25.06.2024; E-Mail i datës 25.06.2024 nga A.I; E-Mail i datës 24.06.2024 nga F.Z; E-Mail i datës 21.06.2024 nga A.I për Q.G, Sh.M; E-Mail i datës 20.06.2024 nga Q.G për Sh.M; E-Mail i datës 14.06.2024 nga Q.Rr; E-Mail i datës 14.06.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 13.06.2024 nga Sh.M për A.K; Kërkese për përkthim E-Mail i datës 19.06.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 14.06.2024 nga Q.G për D.K; E-Mail i datës 14.06.2024 nga Q.G për D.K; E-Mail i datës 27.05.2024 nga A.B; E-Mail i datës 28.06.2024 nga Q.G; E-Mail i datës 01.06.2024 nga A.B; E-Mail i datës 28.05.2024 nga Sh.M; E-Mail i datës 28.05.2024 nga Sh.M për A.K; E-Mail i datës 27.05.2024 nga A.K për Sh.M; Parashtrësë e datës 25.05.2024; Parashtrësë e datës 25.05.2024; E-Mail i datës 03.07.2024 nga Q.G për A.K; E-Mail i datës 24.06.2024 nga Q.G për N.H; E-Mail i datës 24.06.2024 nga A.K për Q.G; E-mail i datës 15.07.2024 nga Q.G për A.H; E-Mail i datës 11.06.2024 nga J.K për A.K; E-Mail i datës 11.06.2024 nga A.K për J.K; E-Mail i datës 11.07.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 11.07.2024 nga J.K për A.K; E-Mail i datës 27.06.2024 nga Q.G për A.K; E-Mail i datës 27.06.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 26.07.2024 nga N.H për J.E; E-Mail i datës 09.07.2024 A.K për S.G; E-Mail i datës 09.07.2024 nga S.G për A.K; E-Mail i datës 08.07.2024 A.K për S.G; E-Mail i datës 03.07.2024 nga S.G për A.K; E-Mail i datës 03.07.2024 nga A.K për S.G; E-Mail i datës 02.07.2024 nga N.Q; E-Mail i datës 02.07.2024 nga Q.G për N.Q; Parashtrësë e datës 27.05.2024; E-Mail i datës 08.07.2024 nga M.L; E-Mail i datës 05.07.2024 nga Q.G për A.K; Konfirmim i datës 05.07.2024 nga M.L; Konfirmim i datës 05.07.2024 nga T.Rr; E-Mail i datës 05.07.2024 nga Q.G; E-Mail i datës 04.07.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 28.08.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 28.08.2024 nga Q.G për A.K; E-mail i datës 28.08.2024 nga Q.G për A.K ; E-mail i datës 27.08.2024 nga Q.G për A.K; E-Mail i datës 27.08.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 27.08.2024 nga Q.G për A.K; E-Mail i datës 27.08.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 27.08.2024 nga A.K për Q.G; Kërkesë për rezervimin e Sallës dhe për përkthim për datën 28.08.2024; E-Mail i datës 27.08.2024 nga D.K; E-Mail i datës 27.08.2024 nga J.K; E-Mail i datës 27.08.2024 nga Q.G; E-mail i datës 08.07.2024 nga Q.G; E-Mail i datës 08.07.2024 nga J.K; E-Mail i datës 27.08.2024 nga Sh.M për Q.G; E-Mail i datës 27.08.2024 nga Q.G; E-Mail i datës 08.08.2024 nga Sh.G për Q.G; E-Mail i datës 08.08.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 08.07.2024 nga Q.G për M.A; E-Mail i datës 08.07.2024 nga Q.G për J.K; E-Mail i datës 08.08.2024 nga Q.G për A.K; E-Mail i datës 08.07.2024 nga A.K për M.A; E-Mail i datës 08.06.2024 nga A.C; E-Mail i datës 08.06.2024 nga Q.G; E-Mail i datës 08.05.2024 nga A.I; E-Mail i datës 09.07.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 05.09.2024 nga A.K për J.B; E-Mail i datës 05.09.2024 nga J.B për A.K; E-Mail i datës 26.08.2024 nga Q.G për sekretarin; E-Mail i datës 23.08.2024 nga A.K; E-Mail i datës 23.08.2024 nga A.K për Q.G; Kërkesë për pagesën e anëtarësisë në EQUINET e datës 26.08.2024; E-mail i datës 29.04.2024 nga A.K; E-Mail i datës 26.04.2024 nga Q.G për A.K; E-mail i datës 26.04.2024 nga Q.G për N.H; E-Mail i datës 25.04.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 23.04.2024 nga I.Rr për N.Q, A.C; E-Mail i datës 06.05.2024 nga Q.G; E-Mail i datës 06.05.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 06.05.2024 nga Q.G për A.K; E-Mail i datës 31.05.2024 nga Q.G për avokatin; E-Mail i datës 31.05.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 29.05.2024 nga S.G për A.K; Parashtrësë e datës 31.05.2024; E-Mail i datës 06.03.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 06.03.2024 nga Q.G për A.K; E-Mail i datës 28.05.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 27.05.2024 nga A.K për Q.G; E-Mail i datës 22.05.2024 nga Q.G. për A.K; E-Mail i datës 21.05.2024 nga Q.G. për avokatin; E-Mail i datës 10.05.2024 nga A.K për Q.G; Raporti mujor- Gusht 2024 ; Raporti mujor-Korrik 2024; Raporti mujor- Qershor 2024; Raporti mujor-Maj 2024; Raporti mujor-Prill 2024; Raporti mujor-Mars 2024; Raporti mujor- Shkurt 2024; - Raporti mujor- Janar 2024; Raporti mujor-Dhjetor 2023; Raporti mujor-Nëntor 2023; Raporti mujor-Tetor 2023; Kopje e letërnjoftimit dhe Vendimin e datës 28.07.2025 për shtytjen e afatit për vendosje të ankesës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ ka gjetur se pretendimet ankimore janë të bazuara, **sepse:**

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se:

- Ankuesja, sipas Akt Emërimit të datës 29.09.2023, ka themeluar marrëdhënie pune në pozitën Zyrtare për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Institucionin e Avokatit të Popullit, me periudhë provuese prej dymbëdhjetë (12) muajsh.

-Mbikëqyrësja e drejtpërdrejt e ankueses, përmes vlerësimit të periudhës provuese, nuk ka konfirmuar periudhën provuese për ankuesen, ndërsa, Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit, më Vendimin me numër protokolli 234/2024, të datës 29.08.2024, ankueses i ka përfunduar marrëdhënien e punës mbi bazën e mos konfirmimit të periudhës provuese nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

-Ankuesja më datë 13.09.2024, ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit, ndërsa, ky i fundit më Vendimin V.nr.1/2024, të datës 13.05.2025, ka refuzuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi Vendimin me numër protokolli 234/2024, të datës 29.08.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit V.nr.1/2025 të datës 13.05.2025, të Komisionit të Ankesave, të Institucionit të Avokatit të Popullit, më pretendimet se ky vendim është nxjerr në kundërshtim me afatet e parashikuar me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Nuk më është caktuar asnjë objektiv për gjatë periudhës provuese në kundërshtim me Rregullores Nr. 02/2017 për Procedurën e Rekrutimit, Emërimi dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Institucionin e Avokatit të Popullit. Të gjitha detyrat që më janë deleguar i kam përfunduar me përgjegjësi të plotë. Vendimi i kundërshtim me ankesë është në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr. 02/2017 për Procedurën e Rekrutimit, Emërimi dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Institucionin e Avokatit të Popullit. Kërkon që të anulohet Vendimi V.nr.1/2025 i datës 13.05.2025, i Komisionit të Ankesave i Institucionit të Avokatit të Popullit, dhe Vendimi me numër protokolli 234/2024, i datës 29.08.2024, i Sekretarit të Përgjithshëm të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe të kthehet në vendin e punës duke kërkuar kompensimin e pagave prej datës 01.10.2024.

Pretendimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit në përgjigjen në ankesë të datës 18.07.2025, deklaroi se sipas Rregullores Nr. 02/2022 për Disiplinën dhe Ankesave e të Punësuarve në institucionin e Avokatit të Popullit, KPMSHCK nuk ka kompetencë të shqyrtoj ankesat e të punësuarve në Institucionin e Avokatit të Popullit, duke njoftuar se Këshilli duhet ti referohet Aktgjykimit Nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Aktgjykimeve të plotfuqishme të gjykatave të rregullta ku kanë vërtetuar ndërhyrjen e KPMSHCK-së në proceset e punësimit në IAP që tejkalojnë kompetencat e vendimarrjes.

Vlerësimi i Kolegjit lidhur me çështjen

Kolegji i Këshillit duke ju referuar nenit 101, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thekson faktin se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është institucion kushtetues me mandat që të siguroj respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, mandat ky i ri konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese përmes aktgjykimit në rastin nr. KO171/18; Aktgjykimit në rastin nr. KO203/19, Aktgjykimit në rastin KO127/21, Aktgjykimin në rastin KO100/22 dhe KO101/22, si dhe Aktgjykimit në rastin KO216/22 dhe KO220/22.

Rrjedhimisht lidhur me kompetencën lëndore të Këshillit për vendosje lidhur me çështjen në procedurë, kolegji ju referua bazës juridike si më poshtë:

I. Kushtetuta e Kosovës:

-Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] *Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.*

- Neni 132 parafi 1: *Neni 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] 1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. ë ankuesit*

II. Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë:

Neni 6 paragrafi 4: *Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë.*

III. Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit:

-Neni 32 paragrafit 1 dhe 2: *“Ndaj të punësuarve tjerë të Institucionit të Avokatit të Popullit zbatohen dispozitat ligjore në fuqi për nëpunësit civilë. Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit zgjidhet në mesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, në një proces të hapur dhe transparent, bazuar në kriteret profesionale. Ndaj të punësuarve në IAP, zbatohen dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, për aq sa nuk cenohet pavarësia kushtetuese e Institucionit”.*

-Neni 37 paragrafit 1: *“Avokati i Popullit nxjerrë Rregulloren e punës, Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin”.*

Referuar kuadrit ligjor si me sipër rrjedhë fakti i pa kontestuar se të punësuar në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) janë nëpunës civil me status të veçantë, duke nënkuptuar se marrëdhënia e punës, rrjedhimisht të drejtat dhe detyrimet përkitazi me marrëdhënien e punës rregullohet në pajtim me parimet e këtij ligj dhe akt të veçantë ligjor. Pra, mbi këtë bazë, vet IAP me Ligjin Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit ka përcaktuar se ndaj të punësuar të këtij institucioni aplikohet legjislacioni i shërbimit civil edhe së përjashtimi i të punësuarve në IAP nga shërbimi civil në bazë të një akti nënligjor(rregullore) cenon rëndë parimin e sigurisë juridike dhe bie ndesh me parimin e ligjshmërisë, sepse, aktet nënligjore duhet të jenë në pajtim me ligjin dhe si të tilla nxirren me qëllim të zbatimit të ligjit përkatës e jo të krijojnë regjim të ri juridik nga ai i përcaktuar me ligj.

Për më tepër, Kolegji i Këshillit vë në dukje faktin se Këshilli në praktiken e tij vendimmarrëse respekton në plotëni pavarësinë funksionale dhe organizative të institucioneve të pavarura kushtetuese, duke përfshirë edhe Institucionin e Avokatit të Popullit, rrjedhimisht, Këshilli në rastin e vendimmarrjes lidhur me kontestet nga marrëdhënie e punës të iniciuara nga të punësuarit e IAP, merr tërësisht në zbatim aktet e brendshme të IAP-i, më të cilat rregullohen specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës së personelit të IAP-it, pra, mbi këto fakte, nuk gjen mbështetje pretendimi i IAP-it se KPMSHCK-ja ka ndërhyrë në proceset e punësimit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Ndër tjera, Këshilli në qasje të tillë të vendimmarrjes e aplikon edhe të të punësuarit e Gjykatës Kushtetuese, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës si institucione të pavarura kushtetuese. Gjegjësisht, një konstatim të tillë kolegji e mbështet edhe në vendimet gjyqësore të gjykatave të rregullta lidhur me kontestet civile/administrative të ngritura nga IAP, me theks të veçantë, Aktgjykimin A.nr.1737/17 të datës 21.05.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin A.nr.2580/2018, të datës 20.05.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin A.nr.2996/18, të datës 07.04.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin ARJ.nr.26/2023, të datës 29.05.2023, të Gjykatës Supreme; Aktgjykimin ARJ.UZVP.nr.56/2023 të datës 25.09.2023, të Gjykatës Supreme, ku me asnjërin nga këto vendime gjyqësore nuk është konstatuar ndërhyrje e Këshillit në pavarësinë e Institucionit e Avokatit të Popullit, apo të jetë përjashtuar kompetenca e Këshillit në raport me të punësuarit e IAP-it.

Lidhur me pretendimin e IAP referuar vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji konsideron një shtrembërim të interpretimit të këtyre vendimeve nga IAP, mbi arsyet se, sipas Aktgjykimit në rastin KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është konstatuar se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën në raport me institucionet e pavarura kushtetuese dhe si i tillë ky ligj nuk mund të zbatohet në raport me këto institucione përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë. Rrjedhimisht, si jo kushtetues ishte shpallur edhe neni 85 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përmes të cilit ishte shfuqizuar Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, dhe në praktiken e vlerësimit të kushtetutshmërisë, dispozitat që konstatohet se nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën, konsiderohen nule dhe nuk prodhojnë pasoja juridike. Andaj, në vlerësimin e kolegjit Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil nuk ishte shfuqizuar në raport me institucionet e pavarura kushtetuese, e sipas të cilit ligj të punësuarit e IAP kishin statusin e nëpunësit civil.

Ndërsa, më Aktgjykimin në rastin KO216/22 dhe KO220/22 të Gjykatës Kushtetuese (lidhur me vlerësimin e disa neneve të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik) është përcaktuar qartë statusi i të punësuarve në institucionet e pavarura kushtetuese nder to edhe të IAP, duke rikonfirmuar edhe një herë mandatin kushtetues të KPMSHCK-së, rrjedhimisht, mbi këtë bazë, Kolegji mori parasysh përcaktimet kushtetuese:

253. Gjykata rikujton që bazuar në nenin 101 të Kushtetutës dhe Ligji për KPMSHCK-në, ky i fundit, është i definuar si institucion **i pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.** Ky funksion, bazuar në të njëjtin ligj, ushtrohet nga 7 (shtatë) anëtarë që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ky Këshill, bazuar në nenin 6 (Funksionet e Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK, ndër të tjera, është përgjegjës për: (i) mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil; (ii) shqyrtimin dhe marrjen e vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil; (iii) mbikëqyrjen dhe procedurën e përzgjedhjes dhe vendosjen nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil; dhe (iv) monitorimin e institucioneve të administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Për më tepër, bazuar në

nenin 7 (Kompetencat e Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK, Këshilli, ndër të tjera, ka të drejtë, (i) të vizitojë çdo institucion që ka të punësuar nëpunës civil; (ii) të ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil; (iii) të intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit; (iv) të kërkojë dhe merr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij; dhe (v) të nxjerr vendime, udhëzime, qëndrime dhe rekomandime. Gjithashtu, bazuar në nenin 20 (Monitorimi i institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil) të Ligjit për KPMSHCK, Këshilli, ka kompetencën që me qëllim të vlerësimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, për çdo vit të monitorojë institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil. Për më tepër, bazuar në nenin 25 (Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike) dhe nenin 28 (Raporti vjetor i Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK, ndër të tjera, është i rregulluar (i) bashkëpunimi me institucionet e administratës publike, duke përfshirë detyrimin që çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që ka kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo ka informacion në këtë fushë, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Këshillin; dhe (ii) raportimin vjetor deri më 31 mars të vitit vijues, lidhur me kryerjen e funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, si institucion i pavarur kushtetues për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, dhe rekomandimet për institucionet e administratës publike

272. Gjykata vëren që bazuar në paragrafin 2 të nenit 5 të Ligjit të kontestuar, ndër të tjera, nëpunësit në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, janë të përcaktuar si “nëpunës të shërbimit civil”. Në anën tjetër, përmes paragrafit 4 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, të punësuarit në administratën e sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Kuvendit të Republikës së Kosovës si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese, janë të përcaktuar si “nëpunës me status të veçantë” dhe rregullimi të cilëve bëhet me akt të veçantë, përkatësisht ligj të veçantë dhe i cili bazuar në paragrafin 3 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, është mbizotëruese ndaj dispozitave të tij. Për më tepër, bazuar në paragrafin 5 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, të njëjtat institucione, gjithashtu përjashtohen nga detyrimi për të kërkuar nga Ministria përgjegjëse për administratë publike përcaktimin e kategorisë së zyrtares/it publik për atë funksion, pozitë apo emërtesë në bazë të ekuivalencës, me rastin e krijimit të funksioneve dhe pozitave të reja.

274. Gjykata ashtu si edhe në Aktgjykimin paraprak përkitazi me Ligjin për Zyrtarët Publik, vë theks në faktin që institucionet e pavarura, nuk mund të veprojnë në vakum në raport me kornizën ligjore të Republikës së Kosovës dhe se të njëjtat gjithashtu i nënshtrohen disa kufizimeve dhe kontrollit, duke përfshirë Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, por pavarësia e tyre kushtetuese përfshirë në aspektin e organizimit të brendshëm e garantuar me dispozita kushtetuese dhe siç është sqaruar përgjatë praktikës gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës tashmë në këtë kontekst, nuk mund të cenohet përmes dispozitave ligjore (shih, ndër të tjera, Aktgjykimin në rastin e Gjykatës, KO203/19, cituar më lart, paragrafët 151-152). Në këtë kontekst, Gjykata vëren që Ligji i kontestuar, për dallim nga ai paraprak, u mundëson institucioneve të pavarura 87 përjashtimin e dispozitave të caktuara të Ligjit të kontestuar, për aq sa të njëjtat mund të cenojnë pavarësinë e tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe rregullimin e funksionimit të administratës dhe organizimit të tyre të brendshëm përmes ligjeve dhe akteve të veçanta.

Ne fakt, referuar edhe përcaktimeve kushtetuese si më sipër, kolegji vlerëson së Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë aplikohet ndër të tjera edhe për institucionet e pavarura kushtetuese, këtu edhe IAP, dhe si rrjedhojë të punësuarit në IAP janë nëpunës civil me status të veçantë, në atë mënyrë që marrëdhënia e tyre e punës dhe organizmi të brendshëm rregullohet me akt të veçantë ligjor, por çdo herë duke respektuar parimet e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë si dhe parimet e përgjithshme të ligjit bazik për shërbimin civil.

Andaj, pas konstatimit të kompetencës lëndore të Këshillit për vendosje lidhur me çështjen në procedurë, Kolegji iu referua Rregullores Nr.02/2017 Për Procedurën e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Institucionin e Avokati të Popullimit, me theks të veçantë:

-Nenit 43 [Kohëzgjatja e punës provuese] 1. *Kandidati i cili kalon me sukses procedurat e rekrutimit dhe të emërimit, pranohet në punë në IAP dhe i nënshtrohet punës provuese në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajsh, për pozitat me afat të pacaktuar, ndërsa tre (3) muaj për pozita me afat të caktuar. 2. Puna provuese në rast të pushimit të lehonisë, pushimit mjekësor dhe/apo në rrethana të tjera të veçanta, zgjatet për kohën sa është bërë ndërprerja e punës provuese.*

-Nenit 44 [Mos aplikimi i punës provuese] *Puna provuese nuk aplikohet për stafin i cili ngritet në detyrë përmes procedurës së avancimit.*

-Nenit 45 [Vlerësimi i periudhës provuese] 1. *Udhëheqësi i drejtpërdrejt, dyzetepesë (45) ditë para përfundimit të punës provuese, e takon nëpunësin dhe bashkëbisedon me të për vlerësimin e punës provuese lidhur me: 1.1 realizimin e detyrave të punës; 1.2 gatishmërinë, dhe vetiniciativën për kryerjen e detyrave të punës; 1.1 respektimin e rregullave të Kodit të Etikës për stafin e IAP-së; si dhe 1.3 respektimin e orarit të punës.*

-Nenit 46 [Rregullat procedurale të punës provuese] 1. *Në ditën e fillimit të punës së nëpunësit, udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe menaxheri i personelit njoftojnë nëpunësin e ri për të drejtat dhe detyrimet si dhe procedurat që duhen ndjekur gjatë kohëzgjatjes së punës provuese. 2. Udhëheqësi i drejtpërdrejt mund ta caktojë një nëpunës me përvojë që ta mbështesë dhe ta ndihmojë nëpunësin e ri gjatë punës së tij provuese. 3. Gjatë punës provuese, nëpunësit mund t'i ofrohet mbështetje përmes trajnimeve të nevojshme për pozitën e tij.*

-Nenit 47 [Konfirmimi ose jo i punës provuese] 1. *Pas takimit të zhvilluar, varësisht nga përmbushja e detyrave të punës, udhëheqësi i drejtpërdrejt vendosë konfirmimin ose jo të vazhdimit të marrëdhënies së punës (Form.IAP-R-13). 2. Udhëheqësi i drejtpërdrejt i nëpunësit, konfirmimin ose jo konfirmimin e tij, të arsyetuar me shkrim, e dërgon tek DBNJ dyzet (40) ditë para përfundimit të punës provuese. 3. DBNJ, pas marrjes së konfirmimit për vazhdimin e marrëdhënies së punës të nëpunësit nga udhëheqësi i drejtpërdrejt, konfirmimin ia bashkëngjet dosjes së nëpunësit. 4. 5. Në rast të moskonfirmimit nga udhëheqësi i drejtpërdrejt për vazhdimin e marrëdhënies së punës, merret vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga Sekretari i Përgjithshëm i IAP-së. DBNJ e informon nëpunësin tridhjetë (30) ditë para përfundimit të punës provuese, me konfirmimin ose jo të tij për vazhdimin e marrëdhënies së punës.*

Referuar kuadrit ligjor si me sipër, Kolegji ka analizuar aktin e kontestuar në ndërlidhje me provat materiale të parashtruara nga pala ankuese dhe si rrjedhojë ka gjetur së akti në fjalë është nxjerrë në kundërshtim me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse Komisioni i Ankesave i IAP-it ka dhënë konstatime të përgjithësuara duke mos shpjeguar qartë situatën faktike mbi të cilën është marrë vendimi dhe shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, rrjedhimisht Komisioni i Ankesave të gjithë vendimmarrjen e mbështet veten në citatin “...Komisioni i Ankesave ka vërejtur së mbikëqyrësja e znj. G. ka ndjekur procedurën duke dhënë këshillat, vërejtjet dhe sugjerimet rreth detyrave të punës, më të cilat ka qenë e ngarkuar znj. G. Po ashtu, Komisioni ka vërejtur së mbikëqyrësja e znj. G. ka hartuar Planin vlerësues për vlerësimin e punës së znj. G. duke paraqitur arsyet dhe provat në të cilat është bazuar kur ka vlerësuar se znj. G. nuk e ka kaluar me sukses punën provuese, respektivisht nuk i është konfirmuar puna provuese. Në fakt, Komisioni i ankesave të IAP, të gjithë vendimmarrjen e bazon vetëm në thëniet e mbikëqyrësës së ankuses, duke anashkaluar vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes së fakteve, gjegjësisht, Komisioni

i Ankesave ka dështuar të vërtetoj faktet relevante të çështjes si: nëse ankuesja kishte plan individual të punës, nëse po, kur ishte hartuar dhe ishte konsultuar ankuesja me këtë plan, cilat kanë qenë vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga mbikëqyrja për ankuesin duke e argumentuar këtë më prova (kur janë dhënë, për çka dhe arsyen pse janë dhënë), a ishin ofruar për ankuesen trajnime të nevojshme për përmirësim të aftësive, mos konfirmim i periudhës provuese të ankueses a ishte si pasojë e paaftësisë profesionale të ankueses apo mos përmbushje e detyrave të punës, çfarë procedurë të vlerësimit kishte ndjekur mbikëqyrja me rastin e vlerësimit të ankueses, rrjedhimisht a kishte zhvilluar takime gjatë periudhës provuese me ankuesen, fakte këto që janë të domosdoshme për një konstatim të saktë nëse mos konfirmimi i periudhës provuese të ankueses ishte i bazuar dhe argumentuar. Andaj, mbi këto konstatime dhe rrethana, Kolegji erdhi në përfundimin së arsyetim i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm i një akti administrativ, është i barabartë me mungesën e tij.

Rrjedhimisht, duke qenë se IAP ka refuzuar përcjelljen e provave që kundër argumentojnë pretendimet ankimore të ankueses, atëherë, kolegji ka shqyrtuar gjithë dëshmitë e proceduara nga palë ankuese dhe që i referohen përmbushjes së detyrave të punës, nga dhe ka vërtetuar së është fakt i pakontestueshëm së mbikëqyrësja kishte dhënë sugjerime të kohëpaskohshme për ankueses lidhur me lëshime të natyrës teknike dhe gjuhësore, mirëpo, më asnjë provë të ofruara nga pala ankuese nuk mund të konstatohet së ankuesja nuk kishte përmbushur apo të kishte refuzuar përmbushjen e detyrave të punës, e në ndërlidhje me këtë fakt, kolegji vlerëson se duke qenë së ankuesja ka qenë në periudhë provuese atëherë edhe gabimet nga ana e saj kanë qenë tërësisht të pritshme, mirëpo, në vlerësimin e Kolegjit mbikëqyrja duhej që për përmirësim të aftësive të punës së ankueses të propozonte trajnime relevante për ankuesen, ose në fund të periudhës provuese të rekomandonte edhe periudhë shtesë nëse kjo është e nevojshme siç, parashihej me nenin 51, paragrafi 5, nën paragrafi 5.2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik. Për më tepër, nga analizimi i komunikimeve në mes të ankueses dhe mbikëqyrëses se saj, kolegji ka vërejtur një gjuhë jo profesionale dhe jo bashkëpunuese të mbikëqyrëses në raport me ankuesen, ashtu që, sipas shkrësive komunikues vërtetohet së kjo e fundit kishte kërkuar komunikim me ankuesen vetëm në rrugë elektronike (përmes emailit) dhe përjashtimisht me telefon dhe atë vetëm në raste urgjente (provë emaili i datës 11.03.2024).

Ankuesja, po ashtu si provë ka të bashkangjitur edhe raportet mujore të punës dhe atë për periudhat” tetor 2023, nëntor 2023, dhjetor 2023, janar 2024, shkurt 2024, mars 2024, prill 2024, qershor 2024, korriku 2024, më të cilat raporte janë evidentuar realizmi i aktiviteteve të shumta nga ankuesja.

Andaj, nisur nga theksimet e sipër cekura, e në mbështetje të nenit 88 dhe 89 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: “**Neni 88 1. Organi publik, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën kontestimore. 2. Faktet tashmë të njohura për organin publik, faktet e njohura botërisht apo faktet e prezumuara me ligj, nuk kanë nevojë të provohen. Neni 89 Organi publik vlerëson, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ**”, e duke u bazuar në provat materiale të ofruara nga pala ankuese, kolegji vlerëson se janë të bazuara pretendimet e ankueses, ndërsa, akti i kontestuar është akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1137/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses Q.G;
- IAP: Avokatit të Popullit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Personelit
- Arkivit të KPMSHCK-së.